



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3373/10 prot.

Datë 08.01.2026

V E N D I M
Nr. 35/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.01.2026, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Kërkesë për rishikimin e vendimit Nr. **1893/2025**, datë 23.12.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-63379-10-01-2025, me objekt “Blerje kazanesh”, me fond limit 12,481,062.00 (dymbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e nje mije e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërrmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike.

Drejtuar: Komisionit të Prokurimit Publik, adresa: Pallati i Kongreseve, Kati i parë, Tiranë

Kërkuesi: Operatori ekonomik “LEON KONSTRUKSION” SHPK me NIPT K71820009I dhe adresë Rruga Tish Dahia, Kompleksi Kika 2, Pallati nr.9, Kati 8, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

I.1. Në datën 02-10-2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-63379-10-01-2025, me objekt “Blerje kazanesh”, me fond limit 12,481,062.00 (dymbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike.

I.2. Në datë 31.10.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

I.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacionit të operatorit ekonomik ankimues dhe raportit të auditit në SPE rezulton, se në datën 11.11.2025, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

- “LEKA - 2007” SHPK	8,913,300 lekë	skualifikuar
- LEON KONSTRUKSION shpk	9,348,790 lekë	skualifikuar
- LUAR Bros shpk	9,361,000 lekë	kualifikuar
- VIBTIS shpk	9.999.900 lekë	skualifikuar
- SARK shpk	10,582,000 lekë	skualifikuar
- PREKA shpk	11,235,642 lekë	skualifikuar
-“ ARTEO 2018” SHPK	11,965,800 lekë	skualifikuar
- POËER INDUSTRIES shpk	12,230,350 lekë	skualifikuar

I.4. Referuar raportit të auditit në SPE rezulton se me datë 21.11.2025 është publikuar njoftimi i i fituesit paraprak të procedurës së mësipërme të prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik.

I.5. Në datën 21.11.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 3373/2025 protokolli, datë 25.11.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/6115 e operatorit ekonomik “LEON KONSTRUKSION” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur.” me Nr. REF-63379-10-01-2025, me objekt “Blerje kazanesh”, me fond limit 12,481,062.00 (dymbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve dhe Puneve Publike.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “LEON KONSTRUKSION” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

1- Pika 2.3.1 – Kapaciteti Teknik - Kriteret e Veçanta të Kualifikimit. Për dëshmitë e mëparshme të realizuara me ente publike, operatori ekonomik nuk ka bashkëngjitur vërtetimin e kërkuar sipas kriterit.

2- Pika 2.3.2 - Kapaciteti Teknik - Kriteret e Veçanta të Kualifikimit.

Certifikata ISO 9001:2015 me të cilën operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur duhet të ketë si objekt objektin e prokurimit.

Certifikata ISO 9001:2015 e sjellë nga operatori ekonomik nuk përfshin kontenierë mbetjesh urbane, objektin e prokurimit..”

I.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3373/1 prot., datë 25.11.2025.

I.8. Përmes shkresës me nr. 2001/14 prot., datë 03.12.2025 me lëndë “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me nr. 3373/3 prot., datë 03.12.2025 autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike ka dërguar në KPP shqyrtimin e ankesës nga ku rezulton, se ky i fundit ka vendosur pranimin pjesërisht të saj si vijon:

[...]Pretendimet tuaja në formularin e ankesës për këtë pikë janë:

Vërtetim i kërkuar sipas pikës 1-pika 2.3.1-kapaciteti teknike-kriteret e veçanta të kualifikimit është paraqitur si pjesë integrale e kontratës së ngjashme “Leon Mobilimi Urban 2”. Nisur nga arsyeja e skualifikimit e dhënë nga KVO dhe pretendimeve tuaja u bë verifikimi në SPE i dokumentacionit të paraqitur nëse vërtetimi i realizimit është bashkëngjitur këtij dokumentacioni. Nga verifikimi në SPE rezulton se vërtetimi i realizimit të kontratës lëshuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit ndodhet në faqen 394 të folderit me emërtimin “Leon Mobilimi Urban 2 Compressed”. Të ndodhur në këto kushte vlerësojmë se pretendimet e ankimuesit Leon Konstruktion shpk qëndrojnë, janë të drejta dhe merren parasysh.

Ju jeni skualifikuar me arsyet e mëposhtme:

1- Pika 2.3.2 – kapaciteti teknik—kriteret e veçanta të kualifikimit.

Certifikata ISO 9001:2015 me të cilën operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur duhet të ketë si objekt objektin e prokurimit. Certifikata ISO 9001:2015 e sjellë nga operatori ekonomik nuk përfshin kontenierë mbetjesh urbane, objektin e prokurimit.

[...] Në DST e publikuara nga autoriteti kontraktor, kapaciteti teknik, pika 2.3.2 thuhet:

Operatori ekonomik që do të realizojë këtë kontratë duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme si më poshtë:

Certifikatë ISO 9001:2015 “Për menaxhimin e cilësisë” ose ekuivalent objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme).

Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH.

[..] Në përmbushje të këtij kriteri, shoqëria Leon Konstruksion shpk ka ngarkuar në SPE dokumentin Leon Iso pdf, certifikatë ISO 9001:2015 lëshuar nga Aqscert me nr. AQS/Q120272024 dhe me objektin si më poshtë:

Ndërtim dhe rikonstruksion i ndërtesave civile dhe industriale, infrastrukturës rrugore, ujësjellësa dhe kanalizime, hapësirave të gjelbërta dhe shesheve. Punime të restaurimit të monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës. Punime të mbrojtjes lumore dhe bonifikime. Fjalori i përbashkët i prokurimit është bazuar në një strukturë bazë, që përfshin kode deri në nëntë shifra, të shoqëruara me një formulim që përshkuan mallrat, punët ose shërbimet, të cilat janë objekt i një procedure prokurimi. Në ccdo rast, për zhvillimin e një procedure prokurimi, autoritetet entet kontraktore duhet të përzgjedhin detyrimisht në sistemin e prokurimit elektronik një prej kodeve të përcaktuara që i korrespondon objektit konkret të prokurimit që në rastin konkret është kontenierë për mbeturina 44613800-8.

Nga shqyrtimi i objektit të veprimtarisë të përshkruar në këtë certifikatë, në asnjë vend të saj nuk citohet objekti i prokurimit sipas së AK në DST “Tregtim kontenierësh/kazanësh” dhe kodit përkatës CPV kontenierë për mbeturina 44613800-8 të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në pikën 2 të seksionit 2 “Objekti i kontratës” të dokumentave të tenderit që është objekt specifik por edhe më tej akoma, nuk ka të përshkruar as objekt import-eksport, transport e tregti mallrash që është një objekt i përgjithshëm dhe që mund të futet në grupin e kodeve CPV materiale ndërtimi dhe produkte ndihmëse për ndërtim duke mos potësuar në këtë mënyrë absolutisht kriterin e përcaktuar në DST. Autoriteti kontraktor gjykon se në certifikatën e lëshuar për subjektin duhet specifikuar domosdoshmërisht aktiviteti konkret për të cilin subjekti përmbush standartin, pasi për certifikimin e një subjekti me një apo më shumë standrte, organizmat certifikuese janë të detyruara të kryejnë auditimet përkatëse të cilat janë specifike sipas fushës së veprimtarisë.

Për sa më sipër skualifikimi i bërë nga KVO është i drejtë, i mbështetur në LPP.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës vlerësojmë se pretendimet e paraqitura nga Leon Konstruksion shpk qëndrojnë pjesërisht, merren parasysht për pikën e parë të ankesës dhe refuzohen për pikën e dytë të saj.

I.10. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se janë paraqitur argumente nga subjekti i interesuar “Luar Bross” SHPK në kuptim të nenit 113 të LPP-së në sistemin e ankesave elektronike, protokolluar me nr. 3373/2 prot., datë 03.12.2025.

I.11. Me vendimin nr. Nr. **1893/2025**, datë 23.12.2025 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-63379-10-01-2025, me objekt “Blerje kazanesh”, me fond limit 12,481,062.00 (dymbëdhjetë milion e katërqind

e tetedhjetë e një mijë e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërrmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike.

- 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.*
- 3. Autoriteti kontraktor të anulojë aktin e KSHA nr. 2001/14 prot., datë 03.12.2025 me lëndë “Kthim përgjigje”.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.12. Me shkresën datë 30.12.2025 me lëndë “Shkresë sqaruese mbi vlefshmërinë procedurale të ankesës dhe vijimin e shqyrtimit të pretendimeve të papranuara, në përputhje me nenet 111 dhe 115 të ligjit për prokurimin publik”, protokolluar pranë KPP-së me nr. 3373/8 prot., datë 30.12.2025, operatori ekonomik “Leon Konstruksion” SHPK ka parashtruar pretendimet si vijon: “[...] Në lidhje me vendimin e Komisionit të pavarur të Prokurimit Publik për shpalljen të pavlefshme të ankesës sime, paraqitur pranë KPP-së, sqaroj sa vijon:

Ankesa mban nr. Protokolli 3373/2025, datë 25.11.2025, si dhe nr. Ankimi elektronik A/2025/6115. Ankesa është protokolluar zyrtarisht në datën 25.11.2025, datë në të cilën janë përmbushur të gjitha kushtet procedurale për paraqitjen e vlefshme të saj, në kuptim të ligjit 111 të ligjit për prokurimin publik.

Veprimi/shpallja e autoritetit kontraktor, objekt ankimi, është publikuar në datën 21.11.2025, ndërsa afati ligjor i ankimit ka filluar në datën 22.11.2025, një ditë pas publikimit të aktit.

Në datën 25.11.2025, fatura për arkëtimin e tarifës së ankimit në masën 0.5 % është gjeneruar fillimisht me gabim, duke u bazuar në një fond limit prej 15,000,000.00 lekë ndërkohë që fondi limit i saktë për procedurën e prokurimit “Blerje kazanesh”, me nr. REF-63379-10-01-2025, është në vlerën 12,481,062.00 lekë. Për këtë arsye, në të njëjtën datë, subjekti ankues Leon Konstruksion ka kërkuar ridërgimin e faturës së saktë. Pas saktësimit të faturës, në datën 25.11.2025 është kryer pagesa e tarifës së ankimit. Bashkëngjitur gjeni edhe faktet, faturën e lëshuar nga KPP dhe mandat pagesën e paguar në datën 25.11.2025.

Në këtë kuadër, data 25.11.2025 përbën datën e vetme në të cilën ankesa është paraqitur në mënyrë proceduralisht të plotë, me dokumentacion të saktë dhe tarifë të paguar, duke rënë brenda afatit ligjor të ankimit.

Referimi i datës 21.11.2025 si datë e paraqitjes së ankesës lidhet vetëm me dërgimin elektronik paraprak dhe nuk përbën datë të paraqitjes së ankesës lidhet vetëm me dërgimin elektronik paraprak dhe nuk përbën datë të paraqitjes procedurale të vlefshme, në kuptim të përmbushjes së kushteve ligjore për shqyrtimin e saj, të parashikuara shprehimisht në nenin 111 të ligjit për prokurimin publik [...]”.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të dokumentacionit bashkëngjitur,

Arsyeton

II.1. Në kuptim e zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij (neni 24 i LPP).

II.1.1. Lidhur me shkresën e operatorit ekonomik “Leon Konstruktion” SHPK me lëndë “Shkresë sqaruese mbi vlefshmërinë procedurale të ankesës dhe vijimin e shqyrtimit të pretendimeve të papranuara, në përputhje me nenet 111 dhe 115 të ligjit për prokurimin publik 5” përmes të cilës ka parashtruar: “[..]Në lidhje me vendimin e Komisionit të pavarur të Prokurimit Publik për shpalljen të pavlefshme të ankesës sime, paraqitur pranë KPP-së, sqaroj sa vijon:

Ankesa mban nr. Protokolli 3373/2025, datë 25.11.2025, si dhe nr. Ankimi elektronik A/2025/6115. Ankesa është protokolluar zyrtarisht në datën 25.11.2025, datë në të cilën janë përmbushur të gjitha kushtet procedurale për paraqitjen e vlefshme të saj, në kuptim të ligjit 111 të ligjit për prokurimin publik.

Veprimi/shpallja e autoritetit kontraktor, objekt ankimi, është publikuar në datën 21.11.2025, ndërsa afati ligjor i ankimit ka filluar në datën 22.11.2025, një ditë pas publikimit të aktit.

Në datën 25.11.2025, fatura për arkëtimin e tarifës së ankimit në masën 0.5 % është gjeneruar fillimisht me gabim, duke u bazuar në një fond limit prej 15,000,000.00 lekë ndërkohë që fondi limit i saktë për procedurën e prokurimit “Blerje kazanesh”, me nr. REF-63379-10-01-2025, është në vlerën 12,481,062.00 lekë. Për këtë arsye, në të njëjtën datë, subjekti ankues Leon Konstruktion ka kërkuar ridërgimin e faturës së saktë. Pas saktësimit të faturës, në datën 25.11.2025 është kryer pagesa e tarifës së ankimit. Bashkëngjitur gjeni edhe faktet, faturën e lëshuar nga KPP dhe mandat pagesën e paguar në datën 25.11.2025.

Në këtë kuadër, data 25.11.2025 përbën datën e vetme në të cilën ankesa është paraqitur në mënyrë proceduralisht të plotë, me dokumentacion të saktë dhe tarifë të paguar, duke rënë brenda afatit ligjor të ankimit.

Referimi i datës 21.11.2025 si datë e paraqitjes së ankesës lidhet vetëm me dërgimin elektronik paraprak dhe nuk përbën datë të paraqitjes së ankesës lidhet vetëm me dërgimin elektronik paraprak dhe nuk përbën datë të paraqitjes procedurale të vlefshme, në kuptim të përmbushjes së kushteve ligjore për shqyrtimin e saj, të parashikuara shprehimisht në nenin 111 të ligjit për prokurimin publik [..]”, KPP nuk mund të komentojë apo shpjegojë vendimet e tij përtej shpjegimeve të bazuara në ligj dhe argumenteve faktike të cilat i ka paraqitur në pjesën “arsyetoi” të vendimit, kjo në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili përcakton se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, dhe merr vendime të cilat janë administrativisht përfundimtare (neni 24/1 i LPP).

II.1.2. Lidhur me argumentat e paraqitura në kërkesën tuaj ju sjellim në vëmendje se KPP, nuk mund të komentojë apo shpjegojë vendimet e tij përtej shpjegimeve të bazuara në ligj e argumenteve faktike të cilat i ka paraqitur në pjesën “arsyetoi” të vendimit. Gjithashtu KPP, sjell në vëmendje të ankimuesit se nenin 30 pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon se: “2.Vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përfundimtare. Këto vendime mund të ankimohen në Gjykatën Administrative të Apelit, në përputhje me nenin 121 të këtij ligji”.

II.1.3. Instituti i rishikimit nga ana e një organi administrativ, të një vendimi të nxjerrë nga vetë organi në fjalë, nuk gjen mbështetje ligjore në Kodin e Procedurave Administrative në fuqi, ndaj KPP vlerëson se duhet ti drejtohet me analogji Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: *“Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur: a) zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkrësë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihenin nga pala gjatë shqyrtimit të saj;*

b) vërtetohet se thëniet e dëshmitarëve apo mendimet e ekspertëve, mbi të cilat është bazuar vendimi, kanë qenë të rreme;

c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit;

ç) vërtetohet se vendimi i dhënë është bazuar në dokumente të falsifikuara;

d) vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës ose të një institucioni tjetër që më pas është prishur;

e) vendimi është në kundërshtim të hapur me një vendim tjetër të formës së prerë të dhënë midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak.

ë) kur Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga RSH”

II.1.4. Në kërkesën e operatorit ekonomik “Leon Konstruktion” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në argumentet e tij, nuk ofrohet apo vërtetohet nga ky operator ekonomik mbi ndonjë fakt apo rrethanë të re. KPP, me këtë rast, gjen me vend të theksojë se, ndërsa çdo subjekt i LPP ka të drejtë të interpretojë dispozitat e këtij legjislacioni, po ashtu, këto subjekte kanë edhe detyrimin ta interpretojnë atë në përputhje e harmoni të brendshme dhe të jashtme me legjislacionin tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Akoma më tej, duke qenë se KPP është organi më i lartë në fushën e prokurimit publik, ka të drejtën dhe përgjegjësinë të bëjë interpretimin përfundimtar të legjislacionit të fushës përkatëse. Akoma më tej, referuar nenit 30 pika 2 të Ligjit nr.162/2020, ku përcaktohet shprehimisht se: *“Vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përfundimtare. Këto vendime mund të ankimohen në Gjykatën Administrative të Apelit, në përputhje me nenin 121 të këtij ligji”*, si dhe nenit 121 pika 1, të Ligjit nr. 162/2020, ku përcaktohet se: *“Ndaj vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik palët e interesuara kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën Administrative të Apelit, që shqyrton mosmarrëveshjet administrative, sipas afateve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”*, sqarojmë se, ashtu sikundër përcaktohet edhe në dispozitivin e vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik, operatorët ekonomikë, në të

gjitha rastet kur mendojnë se vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik kanë cënuar interesat e tyre të ligjshëm, mund të ndjekin hapat e mëtejshëm, për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë kërkesën e operatorit ekonomik “Leon Konstruktion” SHPK, për korrigjimin e vendimit të KPP-së Nr. **1893/2025**, datë 23.12.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-63379-10-01-2025, me objekt “Blerje kazanesh”, me fond limit 12,481,062.00 (dymbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërrmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

